



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-21-4538-5-2-1 dhe nr.brendeshëm 632-21-077-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-29303, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore më dt. 24.03.2025, Zytari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 42, paragrafi 42.1 i KPK përcakton se "Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën"

Neni 38, paragrafi 38.1 i KPK përcakton se: "**Force Majeure**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

Me dt.21.03.2025, menaxheri i kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve të Pika e Zezë-Pjesa -II-të", e lidhur me dt.30.09.2021, me numër të prokurimit : 632-21-4538-5-2-1 dhe nr.brendeshëm 632-21-077-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-29303;

Sipas Menaxherit të kontratës, në vitin 2020 dhe 2021, pandemia globale COVID-19 shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike. Në të njëjtën kohë, ka munguar zgjidhja e problemit të mureve të cilat janë në pronë private dhe ishte e pamundur të bëhen devijime.

Gjithashtu pengesë kanë qenë edhe kanalizimet e kryera nga kompanitë tjera të cilat kanë qenë të përfunduara dhe kanë penguar në punime. Ky problem nuk ka mundur të zgjidhet dhe nuk ka mundur të bëhet devijimi i rrugës sepse ka qenë pronë private, duke e bërë të pamundur për Operatorin Ekonomik që të realizonte detyrimet kontraktuale sipas kushteve fillestare. Operatori Ekonomik Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë, ka hasur në vështirësi të papara për shkak të fakteve që u ceken më lartë, prandaj duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike dhe ato në teren, të dyja palët, Komuna e Gjakovës dhe Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë, kanë arritur në përfundimin se ndërprerja e kontratës është zgjidhja më e arsyeshme dhe e drejtë për të dy palët. Kjo marrëveshje është bërë me mirëkuptim të plotë dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.

Andaj, bazuar në nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.21.03.2025, të menaxherit të kontratës, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 30.09.2021, me numër të prokurimit: : 632-21-4538-5-2-1 dhe nr.brendëshëm 632-21-077-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-29303, me titull " Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve të Pika e Zezë-Pjesa -II-të ", në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë, me nr.unik 811129726, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 25.03.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit

The image shows a circular official stamp of the Municipality of Gjakova. The text in the stamp includes "REPUBLIKA E KOSOVES", "Komuna e Gjakovës", and "Kryetari i Komunës". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink. Below the signature, the text "Udhëheqës i zyrës së Prokurimit" is printed.



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Gjakovë
Qëstina Djakovica
Municipal of Gjakova

DATE:	21.03. 2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj
CC:	Drejtoria për Infrastrukturë, z. Shkumbin Kastrati AL- Engineering, Prishtinë; Valdrin Zenuni – Ornani Mbikqyres z. Ndue Komani- OE
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës me titull: Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve të Pika e Zezë – Pjesa e II-të me nr. identifikimi 632-21-4538-5-2-1, K Gjakovë

Operatori Ekonomik "Roza Komani BI" N.N.SH." KORBEN' Gjakovë ka paraqitur kërkesen Drejtorisë së Infrastrukturës me datën 19.03.2025 që të bëhet me mirkuptim shkëputja e kontratës me titull: Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve të Pika e Zezë – Pjesa e II-të me nr. identifikimi 632-21-4538-5-2-1.

Punimet kanë filluar 30.09.2021, punëkrysi ka ngritur shqetësimin se mosrealizimi i kësaj kontrate ka qenë COVID – 2019 (vitet 2020 – 2021) , si dhe mungon zgjedhja e problemit të mureve të cilat janë në pronë private – ku ky ishte e pamundur të

bëhen devijime si dhe kanalizimet e kryera nga kompanitë e tjera të cilat kanë penguar në punime sepse kanë qenë ta përfunduara. Kemi bërë përpjekje për zgjedhjen e këtij problemi mirëpo nuk kemi mundur të merremi vesh sepse ka qenë ne pronësi private – që te devijohet rruga.

PROPOZIM

Andaj unë Propozoj për zgjedhje të problemit - marrveshje ME MIRKUPTIM

Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha



Kësaj shkrese ja bashkangjes :

- Kërkesa e kompanisë
- Paramasa dhe parallogaria – prerja e punimeve

KORBENK

044 500 810 | 044 133 586 | korben-ks@hotmail.com

ROZA KOMANI B.I
NUI 811129726
NR TVSH-së 330036716
Add: rr.UQK p.n GJAKOVË
Email: korben-ks@hotmail.com
Tel: 048:500810

KËRKESË

Me anë të kësaj kërkesë, kërkojmë nga Komuna e Gjakoves, Drejtoria për Infrastrukturë që me mirëkuptim të na mundësoj shkëputjen e kontrates : **Ndërtimi-asfaltimi I rrugëve te Pika e Zezë-Pjesa -II-të**, me numër identifikues **632-21-4538-5-2-1**, për arsye sepse kjo kontrat është shumë e vjetër, ku nënshkrimi i kësaj kontrate është me datë: 01.10.2021.

Arsyeja për mos realizimin e kësaj është: situata që u krijua nga COVID-2019 në vitet 2020-2021, ku të gjitha ngjarjet u shëndërruan në krizë globale ku çmimet e lëndës së parë pësuan ndryshime të mëdha respektivishtë ngritje të mëdha, si dhe duke u bazuar në kontrat neni 38 "Forca Madhore" ku parashihen edhe epidemit dhe luftat që janë të shkaktuara jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

Gjatë punimeve kemi hasur në mure të cilan janë në prona private dhe nuk ishte e mundur të bëhen devijime, gjithashtu kanalizimet e pununara nga kompania e mëparshme të cilat pengonin në punime sepse nuk ishin të kompletuara dhe të përfunduara.

Si pasojë e këtyre asyeve të lartëcekuar kërkojmë shkëputjen e kontratës me mirëkuptim.

Mbetemi me shpresë që bashkëpunimi jonë me institucionin tuaj do të vazhdoj edhe në të ardhmen me projete të tjera.

Gjitha te mirat,

Roza Komani B.I (NNSH KORBEN)



19.03.2025 Gjakovë

Paramasa dhe Paralogaria (Prerje)

Vendi: Gjakovë

"Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve te Pika e Zezë Faza - II-të"

Nr. Indentifikimit : 632-21-4538-5-2-1

Nr. i brendeshëm: 632-21-077-521

Projekti Kryesor i rruges te pika e zeze, Gjakovë

Paramasa dhe Paralogaria

Rruga Gucia & Adem Delija

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I Punët Pregaditore					
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre dhe shenjat e nevojshme per siguri dhe paralajmërim të vendpunishtës. (Zyra te ketë kushte te mira per pune te jete e paisur me inventar, printer, internet, te ketë favolin shtesë - te veçant për projekt monaxherin dhe organin mbikëqyrës)	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
2	Pastimi i temit kontrollimi i instalimeve nentokesore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasen e rrugës. Ne raste demtimi te instalime ekzistuese (qe janë te bashkangjitur ne projekt nga kompanit regionale) duhet ti rregulloj vetë punëkryesi	m'	688.00	2.00	1,372.00
3	Shenjëzimi i trasës dhe përcjellja e punimeve me gjeodet.	m'	688.00	1.50	1,029.00
Gjithsej totali me TVSH					3,401.00
III Punët e Zhavorit					
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës 50-150mm t=30cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >60 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqeve anësore.	m²	1,029.00	12.00	12,348.00
3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm, t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>90 MPa Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqeve anësore.	m²	654.82	14.00	9,167.48
4	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5 mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >120MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqeve anësore.	m²	720.30	15.00	10,804.50
Gjithsej totali me TVSH					32,319.98
IV Trotualet dhe gjelbeimi					
3.1.	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e rrerës 10-40mm, d=5cm (ne gjendje te ngjeshur)	m²	274.40	25.00	6,860.00
3.2.	Furnizimi dhe montimi i Curve Skajor nga betoni 18/24 cm, te klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin)	m'	400.00	12.00	4,800.00
3.3.	Furnizimi dhe montimi i Curve Skajor nga betoni 10/20 cm, te klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin)	m'	2,744.00	9.00	24,696.00
3.4.	Furnizimi dhe montimi i kubzave nga betoni me trashësi t=6cm per trotuare. Kubzat duhet të jene të klasës C-30/37.Ngjyra dhe modeli te zgjidhen nga Investitori.	m²	5,488.00	10.00	54,880.00
3.5.	Furnizimi dhe rrafshimi dhe perpunimi i dheut per oaza gjelberuese. Ne çmim te perfshihet edhe humusimi i shtreses se sipërme t=15 cm dhe mbjellja e barit. Pjesa më e madhe e dheut do të snfrytëzohet humusi i gërmuar nga trupi i rrugës	m²	258.00	5.00	1,290.00
Gjithsej totali me TVSH					92,526.00
V Punët e Asfaltit					
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 0-16 mm në rrugë dhe kyqe e rugeve ekzistuese. t=8cm	m²	2,746.00	13.00	35,698.00
Gjithsej totali me TVSH					35,698.00
VI Punët e Sinjalizimit					
Sinjalizimi i Vertikal					
1	Furnizimi dhe vendosja e shenjave ne formë trekëndëshi DG	copë	2.00	130.00	260.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e shenjave STOP DG	copë	2.00	130.00	260.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e shenjave ne formë rrethore DG	copë	2.00	130.00	260.00 €
Gjithsej totali me TVSH					780.00
VII Ngritja dhe nivelizimi i Kapakeve					
1	Furnizimi dhe montimi i kapakeve nga materiali i gëlës apo materiali kompozit të klasës C250 sipas EN 124 për pasha të mesme deri në 40 ton. Në çmim të llogaritet edhe rregulimi i kokës së pusëtës ne ne varesi nga terreni me beton C-25/30 dhe një rrjetë armature Q-335	copë	10.00	120.00	1,200.00 €

Gjithsej totali me TVSH					
1	Testimet e ngjeshmërisë	komplet	1.00	250.00	1,200.00
2	Testimet e Asfaltit	komplet	1.00	250.00	250.00 €
3	Testimet e Kubëzave dhe gurëve skajorë	komplet	1.00	250.00	250.00 €
Gjithsej totali me tvsh					750.00 €
REKAPITULLIMI RRUGA					
I	Punët Pregaditore				3,401.00 €
III	Punët e Zhavorit				32,319.98 €
IV	Trotualet dhe gjelbrimi				92,526.00 €
V	Punët e Asfaltit				35,698.00 €
VI	Punët e Sinjalizimit				780.00 €
VII	Ngritja dhe nivelizimi i Kapakeve				1,200.00 €
VIII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				750.00 €
Gjithsej totali me TVSH					166,674.98 €

REKAPITULLIMI		
1	RR. GUCIA & ADEM DELIJA	166,674.98